

20111573421

L I G J
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR
MBIKËQYRJE INSPEKTUESE

Neni 1

Në Ligjin për mbikëqyrje inspektuese "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 50/10 dhe 162/10), në nenin 16 paragrafi (10) fjalët: "Ministria e Drejtësisë" zëvendësohet me fjalët: "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 2

Në nenin 17 paragrafi (3) fjalët: "ministri i Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 3

Në nenin 18 paragrafi (8) fjalët: "Agjencia për Nëpunës Shtetërorë" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 4

Në nenin 19 paragrafi (6) fjalët: "ministri i Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 5

Në nenin 20 paragrafi (1) fjalët: "ministri i Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Në paragrafin (3) fjalët: "Agjencia për Nëpunës Shtetërorë" zëvendësohen me fjalët: "Agjencia e Administratës", ndërsa fjalët: "Ministria e Drejtësisë" zëvendësohet me fjalët: "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Në paragrafin (5) fjalët: "Ministria e Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Në paragrafin (6) fjalët: "ministri i Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 6

Në nenin 21 paragrafi (3) fjalët: "ministri i Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 7

Në nenin 22 paragrafi (1) pas alinesë 3 shtohet alineja e re 4, si vijon:

"- ndihmëskryeinspektor."

Në paragrafin (2) pas fjalës "titull" shtohen fjalët: "bashkëpunëtor i ri dhe".

Në paragrafin (3) pas fjalës "titull" shtohen fjalët "bashkëpunëtor i lartë dhe".

Pas paragrafit (4) shtohet paragrafi i ri (5), si vijon:

"(5) Ndhmëskryeinspektor mund të jetë nëpunësi që i plotëson kushtet për titull ndihmësudhëheqës i sektorit nga Ligji për nëpunës shtetërorë."

Paragrafët (5) dhe (6) bëhen paragrafë (6) dhe (7).

Neni 8

Në nenet 37 paragrafi (9) dhe 40 paragrafi (2) fjalët: "ministri i Drejtësisë" zëvendësohen me fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës".

Neni 9

Në nenin 41 paragrafi (4) fjala "ndërprerje" zëvendësohet me fjalën "ndalim".

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".